

KONTRATË SHIT – BLERJE TË

KUOTËS SË KAPITALIT

Sot, më datë 04.08.2021 është nënshkruar kjo Kontrate Shit-Blerje e Kuotës së Kapitalit (“Kontrata”) ndërmjet:

Ervis Aga, shtetas shqiptar, i biri i Skënderit, lindur në Durrës më 12.03.1989, dhe banues në Adresën Rruga e Elbasanit, Godina Nr.5, Hyrja Nr.2, Shk.4, Tiranë, pajisur me ID me Nr. Personal I90312058B (ketu e me poshte referuar si “Shitësi”);

Dhe

Suzana Pecani, atesia Hysen, memesia Nimet, dtl.24.01.1950, lindur ne Tirane dhe banuese ne adresen: Rruga “Reshit Çollaku”, Nd. Klasik, H.1/3; Ap.11, Njësia Administrative Nr.10, Njesia Bashkiake Nr.10, 1001 Tiranë, pajisur me ID me Nr. Personal F05124015B

Si edhe

Olivet Çumashi, atesia Xhuvi, memesia Pavila, dtl.22.09.1945, lindur ne Korçë e banuese në adresen: Naim Frashëri; Nd. 19; H. 4; Ap. 12; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, pajisur me ID me Nr. Personal (ketu e me poshte referuar si “Blerësi”).

Shitesi dhe Blerësi ne vijim referuar individualisht edhe si “Pale” dhe bashkarisht si “Palet”

BAZA LIGJORE:

- Neni 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar;
- Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar;
- Statuti i 4E-COLOR Shpk.;
- Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve të 4E-COLOR Shpk., datë 03.08.2021 (“Vendimi i Asamblesë”).



KUSHTE PARAPRAKE

MEQENËSE:

- A. Ervis Aga është bashkëortak i **4E-COLOR Shpk.**, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me numër unik identifikimi NUIS K21505002B, me Seli në adresën: Rruga "Ali Demi", ish Kombinati Poligrafik, Magazine me Nr.Pasurise 6/232, ZK.8180, Tiranë, përfaqësuar nga Administratori Z. Erion Çumashi këtu e më poshtë referuar si "**4E-COLOR**" ose "**Shoqëria**"
- B. Kapitali i Shoqërise është prej 100,000,000.00 Leke (*njëqindmilionë leke*), i përbërë nga 3 (tre) kuota me vlere nominale prej:
- Ortaku Ervis Aga, zotëron 1 kuotë me vlere 41,000,000.00 Leke (*dyzetenjëmilion leke*), te cilat përfaqësojnë një pjesëmarrje prej 41% te kapitalit te Shoqërise;
 - Ortakja Suzana Pecani zotëron 1 kuotë me vlere 24,500,000.00 Leke (*njëzetekatërmilionë e pesëqindmijë leke*), te cilat përfaqësojnë një pjesëmarrje prej 24.5% te kapitalit te Shoqërise; dhe
 - Ortakja Oliveti Çumashi zotëron 1 kuotë me vlere 34,500,000.00 Leke (*tridhjetëekatërmilionë e pesëqindmijë leke*), te cilat përfaqësojnë një pjesëmarrje prej 34.5% te kapitalit te Shoqërise
- C. Shitesi dëshiron te shesë, dhe Bleresi pranon te bleje Kuotën me pjesëmarrjen prej 41% në shoqëri të Shitësit, me vlere 45,000,000.00 lekë (*dyzetepesëmilionë leke*), që zoterohet nga Shitesi ("**Kuota Target**");
- D. Shoqëria ka miratuar transaksionin dhe ka marrë përsipër përmbushjen e detyrimeve të kësaj Kontrate, në përputhje me marrëveshjen për Zëvendësimin e Debitorit.

ATËHERË, bazuar në sa me sipër, Palet pranojnë te lidhin kete kontrate qe ekzekuton shitjen e Kuotes Target (ne vijim "**Kontrata**") si vijon:

Neni 1

OBJEKTI

Objekti i kësaj Kontrate është shitja e Kuotës Target dhe e gjithë pjesëmarrjes në Shoqëri, nga Shitësi në mënyrë të barabartë tek Blerësi mes dy Ortakeve Suzana Pecani dhe Oliveti Çumashi, të cilat do të blejnë respektivisht 1/2 e Kuotës (20,5% pjesë takuese secilit nga



ortakët Blerës), në pronësi të Ortakut Shitës. Blerja do të kryhet kundrejt pagimit të çmimit të Kontratës nga Blerësi tek Shitësi.

Neni 2

ÇMIMI DHE MËNYRA E PAGESËS

2.1. Çmimi i Kuotës Target është prej 45,000,000.00 lekë (dyzetepesëmilionë leke). Likudimi i çmimit të Kontratës, do të kryhet në favor të Blerësit në llogarinë bankare, me të dhënat vijuese:

Përfituesi: Ervis Skënder Aga

Banka: CREDINS Sha.

Nr. Llogarie: 00001561511

IBAN: AL14 2121 1009 0000 0000 0156 1511

2.2. Likudimi i çmimit të Kontratës, me pëlqimin e Shitësit, do të kryhet nga Shoqëria, në përputhje me detyrimin e marrë përsipër në emër dhe për llogari, të Blerësit, në këtë formë:

a. me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Shoqëria, në cilësinë e titullarit zëvendësues i Blerësit (debitor), do të nënshkruajë një Kontratë Huaje me interesa, duke kryer pagimin në emër të vet dhe për llogari të Palës Blerëse të pjesës së çmimit prej 15,000,000 lekë plus interesat. Në përputhje me mënyrën e pagimit, Pala Shitëse dhe Shoqëria do të lidhin Marrëveshjen e Huasë me interes 5% në vit e pandryshueshme, me afat ripagimi 5 vjet.

b. me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Shoqëria, në cilësinë e zëvendësuesit të Blerësit/debitor, do të lidhë një Kontratë për Pagimin e pjesës së mbetur të çmimit prej 30,000,000 lekësh në favor të Palës Shitëse, me kreditime të llogarisë bankare të Palës Shitëse, brenda një afati 5-vjeçar. Shoqëria dhe Pala Shitëse, do të lidhin Marrëveshjen e Huasë pa interesa për shumën 30,000,000.00 lekë, me afat 5 vjet, i pagueshëm 2 herë në vit që konsiston në 3,000,000.00 lekë çdo muaj tetor dhe çdo muaj mars.

2.3. Me qëllim garantimin e përmbushjes së detyrimit të përcaktuar në këtë Kontratë dhe Marrëveshjet e Huave, Blerësi në cilësinë e Garantuesit, do të vendosin peng pjesën takuese të Kuotave së Shoqërisë, e regjistruar në Regjistrin e Barrëve Siguruese (RBS)



dhe do të mbetet në fuqi, deri në momentin e shlyerjes së pagesës së fundit, që përbën edhe momentin e çlirimit të kuotave nga barra.

Neni 3

KUSHTET E KONTRATËS

- 3.1. Nepermjet kesaj Kontrate, Shitesi i shet dhe i transferon Bleresit pronësinë mbi kuotën target deh të gjithë pjesëmarrjes në Shoqëri, në raport me pjesën takuese. Blerësi, pranon dhe blen, Kuotën Target me nje çmim të barabartë me 45,000,000.00 lekë (dyzetepesëmilionë leke), e cila do te paguhet sipas Nenit 2.2 më sipër. Me pagimin e kësaj vlere, Shitësi nuk do të ketë asnjë pretendim sot dhe në të ardhmen për dividendin e papaguar në vite të mëparshme dhe për ato të investuara në Shoqëri, duke i konsideruar të shlyera nëpërmjet ekzekutimit të kësaj Kontrate.
- 3.2. Palet bien dakort qe nënshkrimi i kësaj Kontrate, është i vlefshëm për regjistrimin e ndryshimit të strukturës së pronësisë së Shoqërisë në Regjistrin Tregtar të QKB.
- 3.3. Nëpërmjet ekzekutimit të kësaj Kontrate, struktura e pronësisë së Shoqërisë, do të ndryshojë. Ortakë të Shoqërisë, do të jenë vetëm:
 - Suzana Pecani, do të zotërojë 1 kuotë me vlere 45,000,000.00 Leke (dyzetepesëmilionë leke), te cilat përfaqësojnë një pjesëmarrje prej 45% te kapitalit te Shoqerise; dhe
 - Oliveti Çumashi, do të zotërojë 1 kuotë me vlere 55,000,000.00 Leke (pesëdhjetëepesëmilionë leke), te cilat përfaqësojnë një pjesëmarrje prej 55% te kapitalit te Shoqerise.

Neni 4

DEKLARIME DHE GARANCI

- 4.1. Shitesi deklaron dhe garanton se eshte i vetmi pronar dhe titullar i Kuotës Target dhe i të drejtave qe rrjedhin prej saj.
- 4.2. Shitesi deklaron dhe garanton se Kuota Target eshte e lire nga cdo peng, privilegj, barre, apo çdo e drejte tjeter ne favor te te treteve.



- 4.3. Blerësi deklaron dhe garanton se ka autorizuar Shoqërinë për përmbushjen e detyrimeve, që rrjedhin nga Shitja në kohën dhe në shumën e parashikuar për secilën pagesë.
- 4.4. Blerësi deklaron dhe garanton, që pa u përfunduar kushti i parashikuar në këtë Kontratë, nuk do të kryejë ndonjë aktivitet, i cili do të përkeqësojë situatën financiare dhe likuiditetin e Shoqërisë.
- 4.5. Blerësi deklaron dhe garanton, se gjatë afatit të kësaj Kontrate, nuk do të bëjë ndryshime, tjetërsime apo pjesëtime të kuotave të Shoqërisë.
- 4.6. Blerësi me nënshkrimin e kësaj Kontrate, do të bëjë regjistrimin e ndryshimit të pronësisë së Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 4.7. Blerësi merr përsipër të gjitha Shpenzimet ligjore si dhe cdo shpenzim tjetër që lidhet me Kontraten apo shpenzimet për veprime të tjera të përfshira në transaksionin mes Palëve.
- 4.8. Pamundësia e Palëve për finalizimin e ndonjë prej marrëveshjeve të përcaktuara shprehimisht në këtë Kontratë, do të anulohet të gjithë marrëveshjen dhe transaksionin mes Palëve, duke i kthyer Palët në gjendjen e mëparshme. Pala përgjegjëse për anulimin e Kontratës, do të shpërblejë dëmin e shkaktuar, në përputhje me parimet e Kodit Civil.

Neni 5

NJOFTIMET

- 5.1. Te gjitha njoftimet, kërkesat apo komunikimet e tjera ndërmjet Palëve duhet të behen vetëm me shkrim dhe të dërgohen pranë adresave të secilës Pale, si me sipër përcaktuar.
- 5.2. Te gjitha njoftimet, kërkesat apo komunikimet, do të dërgohen me letër rekomande me kthim përgjigje ose me email.
- 5.3. Çdo njoftim, kerkese apo komunikim tjetër do të konsiderohet i marrë efektimisht nëse ekzistojnë kushtet e mëposhtme: a) është dërguar me postë, në datën e dorëzimit tek marrësi që do të vertetohet me fletën e kthimit; b) nëse është dërguar me e-mail, në ditën e nesërme të punës të dërgimit tek marrësi.




Neni 6

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE


Palet angazhohen te zgjidhin me mirekuptim cdo mosmarreveshje qe lidhet me interpretimin dhe/ose ekzekutimin e kesaj Kontrate. Nese nje gje e tille nuk eshte me e mundur, mosmarreveshja do te zgjidhjet ekskluzivisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Kjo Kontrate behet e vlefshme me nenshkrimet e saj nga Palet. Kjo Kontrate hartohet ne 4 (kater) kopje origjinale ne gjuhen shqipe te gjitha te nenshkruara nga Palet.

SHITËSI

Erud Aga


BLERËSI

Oliveri Cumi

Luziana Pecani
